

11 prill 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 31.01.2025, dhe Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore (PG) të datës 20.08.2025, si dhe sipas Ankesës së KB Vëllaznimi të datës 10.04.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së (“KAA”), me datë 11.04.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Vëllaznimi e datës 10.04.2026;
- II. REFUZOHET Ankesa e KB Vëllaznimi e datës 10.04.2026 si e PABAZUAR;
- III. VËRTETOHET Informatori Nr. XXVIII/2025-26 i Komisionit të Garave i datës 10.04.2026.

A R S Y E T I M

Më datë 10.04.2026, Komisioni i Arbitrazhit i FBK-së, përmes postës elektronike, nga Sekretarja e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Vëllaznimi të po të njëjtës datë, ndaj Informatorit Nr. XXVIII/2025-26 të Komisionit të Garave të datës 10.04.2026 (tash e tutje “Informatori”), përkatësisht konstatimit të renditjes përfundimtare tabelare dhe rënies së KB Vëllaznimi nga ProCredit Superliga (tash e tutje “Ankesa”).

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim lidhur me çështjen në fjalë, më 11.04.2026, dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Vëllaznimi, si dhe argumentet e ofruara nga klubi. Gjatë vlerësimit të lëndës, përveç rregullativës së brendshme të FBK, KAA gjithashtu ka analizuar me vëmendje edhe Rregullat Zyrtare të Basketbollit si dhe kornizën ligjore në Republikën e Kosovës.

Edhe pse Ankesa e KB Vëllaznimi i referohet “Publikimit/Njoftimit zyrtar të rradhitjes përfundimtare tabelare për edicionin e rregullt basketbollistik senior në vitin 2025/2026, të publikuar nga FBK me dt. 10.04.2026 në web-faqen zyrtare dhe rrjetin social ‘Facebook’“, ndaj të cilit nuk lejohet ankesa, sipas kuptimit të KAA, në fakt përmes kësaj anese, KB Vëllaznimi sfidon Informatorin e KG të identifikuar më sipër duke aluduar ndër të tjera se KG ka aplikuar gabimisht Propozicionet e Garave për Kategoritë Seniore, edicioni 2025/26 (PG) dhe se Informatori i KG është

dashur të bazohet ekskluzivisht në nenin 47.1.4. të PG – që sipas klubit do të evitonte rënien nga ProCredit Superliga. Rrjedhimisht, kërkon ndër të tjera nga KAA që të “APROVOHET si e bazuar ankesa e KB “Vllaznimi” e parashtruar ndaj rradhitjes përfundimtare tabelare në edicionin e rregullt basketbollistik për senior në vitin 2025/2026 të publikuar nga FBK me dt. 10.04.2026 në web-faqen zyrtare, ashtu që NDRYSHOHET rradhitja përfundimtare tabelare dhe e njëjta bëhet vetëm mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në nenin 47.1.4 të P.G, përkatësisht parashtruesi i ankesës KB “Vllaznimi” rradhitet në vendin e 7-të në tabelën përfundimtare të edicionit të rregullt basketbollistik për senior në vitin 2025/2026.”

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, se KB Vëllaznimi ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Informatorit të KG. Njëheri, KB Vëllaznimi ka paguar edhe taksën obligative për parashtrim të ankesës. Rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, bazën ligjore dhe nënligjore, duke përfshirë por pa u kufizuar në, kornizën ligjore në Republikën e Kosovës, rregullativën e brendshme të FBK-së, Rregullat Zyrtare të Basketbollit (RRZB), praktikën nga Court of Arbitration for Sport (CAS), dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

KG në Informatorin e tij, në pjesën e titulluar “Me xhiron e XXVIII përfundon pjesa e rregullt e kampionatit Procredit Superliga Meshkujt 2025/26”, në faqen e fundit, konstaton se “KB Vëllaznimi bie nga Pro Credit Superliga dhe sezonin e ardhshëm do të garojë në Ligën e Parë Meshkujt.”

Çështja për shqyrtim nga KAA në këtë rast, ndërlihet me aplikimin e dispozitave përkatëse nga PG, në rrethanat faktike me të cilat është ballafaquar klubi ankimor në këtë rast. Sipas vlerësimit të KAA, dispozitat e aplikueshme nga PG që e adresojnë situatën faktike në të cilën është gjendur KB Vëllaznimi janë nenet 47.1.4 dhe 47.1.5. KAA vlerëson se normat juridike nuk mund të interpretohen individualisht të izoluar nga tërësia e normave në atë kornizë ligjore. Pa dyshim, mënyra se si janë të hartuara këto dy dispozita len paqartësi lidhur me mënyrën se si vlerësohet rradhitja e klubeve kur të njëjtat kanë numrin e njëjtë të pikëve.

Nëse merret për bazë interpretimi i ngushtë i bazuar ekskluzivisht në pikën 47.1.4., ashtu si e sugjeron KB Vëllaznimi, atëherë kjo do të krijonte kundërthënie në mes të PG dhe RRZB. Nëse kjo qëndron, atëherë sipas vlerësimit të KAA, implikohet neni 5 i PG, i cili thotë në pjesën relevante:

Në rast të çfarëdo mospërputhjeje mes këtyre Propozicioneve dhe Rregullave Zyrtare të Basketbollit, këto të fundit do të jenë mbizotëruese dhe këto Propozicione do të ndryshohen përkitazi.

Si pasojë, në zbatim të nenit 5, Shtojca D (Appendix D) e RRZB thotë në pjesën relevante (përkthim jo-zyrtar nga KAA):

D.1.3 Nëse 2 ose më shumë ekipe kanë të njëjtin bilanc fitoresh-humbjesh në të gjitha ndeshjet e grupit, ndeshja(t) ndërmjet këtyre ekipeve do të vendosë klasifikimin. Nëse këto 2 ose më shumë ekipe kanë të njëjtin bilanc fitoresh-humbjesh në ndeshjet ndërmjet tyre, do të përdoren kriteret shtesë në rendin vijues:

- Diferenca më e lartë e pikëve në ndeshjet ndërmjet tyre.
- Numri më i lartë i pikëve të shënuara në ndeshjet ndërmjet tyre.
- Diferenca më e lartë e pikëve në të gjitha ndeshjet e grupit.
- Numri më i lartë i pikëve të shënuara në të gjitha ndeshjet e grupit.

Nëse, pas zbatimit të këtyre kriterëve, nuk mund të merret një vendim përfundimtar në përfundim të fazës së grupeve, renditja përfundimtare në Garat e Ekipeve Kombëtare do të përcaktohet sipas renditjes përkatëse të FIBA-s. Në të gjitha garat e tjera ku nuk ekziston një renditje e FIBA-s, klasifikimi përfundimtar do të përcaktohet me short.

D.1.4 Nëse në cilindo nivel të këtyre kriterëve një ose më shumë ekip(e) janë tashmë të klasifikuara, procedura e pikës D.1.3 do të përsëritet nga fillimi për të gjitha ekipet e mbetura që ende nuk janë klasifikuar. (theksimi i shtuar nga autori).

Bazuar në dispozitën e cituar më sipër, është e qartë për KAA që KG në Informator ka bërë konstatimin e saktë sa i përket renditjes përfundimtare tabelare të edicionit të rregullt 2025/26 të ProCredit Superligës. Për këtë arsye, KAA vërteton konstatimin e KG në Informator.

KAA ka marr parasysh pretendimin e klubit ankimor për interpretim sistematik të normave juridike ku pretendohet se pika 47.1.4 vjen para pikës 47.1.5, mirëpo siç u cek më sipër, sipas vlerësimit të KAA, radhitja e normave nuk arsyeton zbatimin e një norme ndërsa injorimin e tërësishëm të një norme tjetër, ku të dyja normat flasin dhe adresojnë çështjen në shqyrtim. Po ashtu, fokusi tek fjala “vetëm“ prapë injoron normën e aplikueshme 47.1.5. nga neni 47 i PG, si dhe ashtu

si u cek më sipër, krijon konflikt në mes të PG dhe RRZB, me ç'rast në bazë të nenit 5 të PG, aplikohet Shtojca D e RRZB, e cituar më sipër.

KAA ka vlerësuar edhe pretendimin e KB Vëllaznimi për përjashtim të normativës të FIBA-s duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-277 për Sport si dhe rastet nga CAS. Pretendimi i KB Vëllaznimi në nenin 33.1 të Ligjit Nr. 08/L-277 për Sport (LS) është i pabazuar sepse i jep kuptim të gabuar kësaj norme, si përjashtuese ndaj zbatimit të RRZB pasi që neni 33 i LS duhet lexohet bashkërisht edhe me nenin 32 të LS, i cili në pikën 2 thotë: 'Gara sportive e organizuar nga federatat sportive ose anëtarët e tyre zhvillohet në përputhje me aktet përkatëse të federatës sportive që përcaktojnë elementet bazë të sistemit të garave në kategori të ndryshme të moshave dhe në rang garash qoftë në atë të nivelit lokal, rajonal apo shtetëror.' Kjo e bën të qartë se garat vendore organizohen në përputhje me aktet e FBK-së, ndërsa në rastin konkret, për shkak të kundërthënies që u sqarua më sipër, aktet e FBK-së, përkatësisht PG, e bëjnë të qartë se RRZB mbizotëron. Në fakt, vet anëtarësimi i FBK në FIBA kushtëzohet me zbatimin e RRZB, dhe për këtë KAA citon nenin 9.4 të Statuteve të Përgjithshme të FIBA-s (edicioni 16 maj, 2025), i cili thotë në pjesën relevante (përkthim jo-zyrtar nga autori):

'Federatat anëtare kombëtare duhet të sigurojnë që basketbolli në vendin e tyre të luhet në përputhje me Rregullat Zyrtare të Basketbollit, dhe që Kalendari i FIBA-s dhe detyrimi për të liruar lojtarë për ekipet kombëtare në përputhje me Rregulloret e Brendshme të FIBA-s të respektohen. Ky detyrim i federatave anëtare kombëtare vlen si për garat kombëtare ashtu edhe për ato ndërkombëtare që luhen në vendin e tyre.'
(theksimi i shtuar nga autori).

Rrjedhimisht, ky pretendim i klubit është i pabazuar.

Po ashtu, KAA ka marr parasysh pretendimin e KB Vëllaznimi për përjashtim të normativës të FIBA-s, duke aluduar se bazuar në rastet nga CAS, "çështja e përcaktimit të kriterëve për klasifikim të rradhitjes tabelare të klubeve, është çështje që ekskluzivisht rregullohet nga FBK me anë të Propozicionit të Garave në edicionin përkatës." Sipas vlerësimit të KAA, ky qëndrim është i pabazuar, për arsye se RRZB qartazi flasin për çështjen e rradhitjes tabelare dhe rastet e CAS të cituara nga KB Vëllaznimi nuk ndërlidhen me pretendimin dhe qëndrimin e prezantuar nga KB Vëllaznimi.

Pretendimet tjera që ndërlidhen me 'Asisti Online' dhe me diskutime jo-zyrtare që KB Vëllaznimi mund të ketë pasur me individë të caktuar, gjithashtu vlerësohen nga KAA si të pabazuara për arsye se 'Asisti Online' nuk është organ zyrtar i FBK-së (dhe si i tillë nuk ka asnjë kompetencë për

vlërësimin e normave juridike) dhe vlerësimet jo-zyrtare të individëve nuk janë përcaktuese sa i përket vlerësimin të normave juridike që adresojnë rastet si ky.

Prandaj, KAA, duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Komisioni i Arbitrazhit:



Partin Pruthi
Anëtar



Korab R. Sejdiu
Kryetar



Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 11 prill 2026



Vendimi i dërgohet:

- KB Vëllaznimi
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së

Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e KAA kanë të drejtë të ankesës tek Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.